ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2025

Shkolla Profesionale Elbasan

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024- 2025) 17
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2025) 18
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024-2025) 18
Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024-2025) 24
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2024-2025) 26
Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024- 2025) 26
Tabela 8 Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024-2025) 27
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024- 2025) 29
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2024 2025) 30
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024 - 2025) 31
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2024- 2025) 32
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025) 33
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024- 2025) 34

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024-2025) 12
Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2024-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 14
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025) 15
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025) 16
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 16
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 18
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2024-2025) 19
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 20
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 21
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025) 22
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2024- 2025) 22
Figura 18: Lloji i kontratës (2024-2025) 23
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025) 24
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 25

Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2024-2025) 27
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2024-2025) 27
Figura 23: Lloji i institucionit (2024-2025) 28
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2024-2025) 29
Figura 25: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024-2025) 30
Figura 26: Metodat e kërkimit për punë (2025) 31
Figura 27: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2024-2025) 32
Figura 28: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024- 2025) 33
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025 34

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8
Të diplomuarit 2025 10
Analiza e rezultateve 12
Statusi i punësimit 12
Lidhja e punës me fushën e arsimit 15
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 17
Niveli i pagave 18
Kushtet e punës 22
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 24
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 25
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 26
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 27
Të diplomuarit pa punë 30
Propozimet për përmirësim në shkollë 32
Planet për të ardhmen 34

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të Shkollës Profesionale Elbasan në vitin 2025.

- Në vitin 2025, 68% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 17% . Të pyetur nëse po kërkonin punë, 75% e të diplomuarve të papunë të vitit 2024 u përgjigjën që po kërkonin punë.
- Për të diplomuarit e vitit 2025, të diplomuarit në Termohidraulikë kanë shkallën më të lartë të punësimit me 80% ndjekur nga 79% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm, 73% e të diplomuarve në Mekanikë, 70% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 70% e të diplomuarve në SHMT, 64% e të diplomuarve në Ndërtim, 48% e të diplomuarve në TIK, 38% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes janë të punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, shkalla më e lartë e papunësisë është tek të diplomuarit 46% e të diplomuarve në Ekonomi – Biznes, 27% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 18% e të diplomuarve në Ndërtim, 13% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 13% e të diplomuarve në SHMT, 12% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 9% e të diplomuarve në Mekanikë. Të diplomuarit në TIK janë të diplomuarit që ndjekin më shumë studime të mëtejshme (24%) vijuar nga të diplomuarit në degën e Ekonomi-Biznes (15%), SHMT (17%), Ndërtim (18%), Mekanikë (18%), Termohidraulikë (7%), Hoteleri-Turizëm (9%), Elektronikë (9%).
- Të diplomuarve në vitin 2024 u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, përkatësisht, drejtimi Elektroteknikë me 79%, 74% në Termohidraulikë, Hoteleri Turizëm me 67%, Ekonomi- Biznes me 67% dhe SHMT me 63%. Të diplomuarit me përqindjen më të ulët të lidhjes së punës me fushën e arsimit janë Mekanikë, TIK dhe Ndërtim.
- 41% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë “shumë” dhe “jashtëzakonisht shumë”,
- Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 22% deri në 50,000 lekë, 12% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 18% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 10% paguhen në fashën 80,001 – 95,000 lekë, 10% paguhen 95,001- 120,000 lekë dhe 28% paguhen mbi 120,001 lekë.
- 66% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit.
- 62% e të diplomuarve të vitit 2025, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale me një rënie me 2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Për më tepër,22% e të diplomuarve kanë gjetur punë nga praktika profesionale në biznes me një rritje prej 5 pikë përqindje krahasuar me 2024 dhe 9% kanë gjetur punë nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta ku vihet re një rënie me 3 pikë përqindje krahasuar me 2024.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2025, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/ jashtëzakonisht shumë”. Theksi këtë vit, është

tek nevoja për përmirësimin e praktikave në shkollë (55%), përmirësimi i bashkëpunimit me bizneset (57%), përmirësimin e praktikave në biznes (56%), këshillimi në karrierë (53%) etj.


- Brenda dy viteve të ardhshme, 45% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Për më tepër, 28% duan të kenë gjetur një punë që lidhet me profesionin e tyre, si dhe 27% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë të punësuar.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **Profesionale Elbasan**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për Punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **dy brezave të diplomuar në vitin 2024 dhe 2025** në Shkollën Profesionale Elbasan.

Të diplomuarit 2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në Shkollën Profesionale Elbasan u diplomuan 271 nxënës (shiko tabelën 1).

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2023-2024	271	230	85%

Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 230 nxënës ose 85% e të diplomuarve. Nga këta, 206 ishin djem (90%) dhe 24 (10%) ishin vajza (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=230)*

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve jepet në figurën 2. Përkatësisht, 6% e të gjurmuarve i përkasin drejtimit Ekonomi - Biznes, 10% Elektroteknikë, 19% Hoteleri – Turizëm, 13% Termohidraulikë, 10% Mekanikë , 5% Ndërtim, 23% SHMT dhe 14% TIK.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=230

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 82% e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, dhe 18% jashtë vendit (shiko figurën 3). Krahasuar me një vit më parë vihet re një rritje me 2 pikë përqindje e të gjurmuarve që jetojnë në Shqipëri

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=230);

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2024-2025), nga një total prej 230 të anketuarish 47% ishin të punësuar, 14% ishin të vetëpunësuar, 14% ishin student/kursant, 7% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 18% të diplomuar një vit pas diplomimit.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=230

Për vitin 2025, rezultatet tregojnë se 68% e të diplomuarve janë të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit (shiko figurën 5). Viti 2025 shënon një rritje të punësimit me 2 pikë përqindje nga viti i kaluar (66%). Gjithashtu, duhet theksuar se numri i nxënësve të diplomuar ka ardhur në rritje të ndjeshme nga viti paraardhës (referohu tabelës 1). Mesatarja e punësimit për të dy brezat e gjurmuar është 67%. Ndërkohë, të papunë janë mesatarisht 2024-2025, 19% e të diplomuarve. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin mesatarisht 13% e të diplomuarve.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=181), **2025** (N=230).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2025, 47% e të diplomuarve të gjurmuar janë të punësuar dhe 14% janë të vetëpunësuar (shiko figurën 6). E njëjta përqindje ka qenë dhe për të diplomuarit e vitit 2023-2024.

Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2024-2025)



***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024**: (N=140).*


Në figurën 6, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 80% e të diplomuarve në Termohidraukë, 79% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm, 73% e të diplomuarve në Mekanikë, 70% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 70% e të diplomuarve në

SHMT, 64% e të diplomuarve në Ndërtim, 48% e të diplomuarve në TIK, 38% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes janë të punësuar një vit pas diplomimit.

Ndërkohë, 46% e të diplomuarve në Ekonomi – Biznes, 27% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 18% e të diplomuarve në Ndërtim, 13% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 13% e të diplomuarve në SHMT, 12% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 9% e të diplomuarve në Mekanikë, janë të papunë një vit pas diplomimit.

Sikurse e tregon edhe figura 6, të diplomuarit në degën e Ekonomi-Biznes (15%), TIK (24%), SHMT (17%), Ndërtim (18%), Mekanikë (18%), Termohidraulikë (7%), Hoteleri-Turizëm (9%), Elektronikë (9%) janë të diplomuarit të cilët vijojnë studime të mëtejshme.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: EB** (N=25), **HT** (N=43), **TIK** (N=52); **SHMT** (N=98); **MEK** (N=39); **ISH** (N=28), **ELE** (N=52), **TK** (N=6), **ND** (N=11)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 7), të dhënat tregojnë se 71% e djemve dhe 42% e vajzave janë të punësuar dhe vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Pa punë janë 16% e djemve dhe 33% e vajzave. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin vetëm 13% e djemve dhe 25% e vajzave.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=206); **F** (N=24)

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 62% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 38% u shprehën që nuk lidhet.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **2024** (N=95), **2025** (N=105)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 9), vërehet se përqindjet më të larta të lidhjes së punës me fushën e arsimit i kanë drejtimi Elektroteknikë me 79%,

74% në Termohidraulikë, Hoteleri Turizëm me 67%, Ekonomi- Biznes me 67% dhe SHMT me 63%. Të diplomuarit me përqindjen më të ulët të lidhjes së punës me fushën e arsimit janë Mekanikë, TIK dhe Ndërtim.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. ; **Baza 2024:** N_{EB}=5; N_{Ele}=17; N_{TIK}=11; N_{HT}=16; N_{Mek}=8, N_{SHMT}=21, N_{TK}=2, N_{ISH}=15, **Baza 2025:** N_{EB}=13; N_{Ele}=6; N_{TIK}=16; N_{HT}=30; N_{Mek}=17, N_{SHMT}=60, N_{Nd}=6, N_{Termo}=19, N_{Ndr}=16, N_{Ele}=14

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 72% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 60% të gjinisë femërore janë të punësuar në një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit. Si dhe 28% e të diplomuarve te gjinisë mashkullore dhe 40% te diplomuarve të gjinisë femërore janë punësuar në një punë që nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=32); **F** (N=10)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), të diplomuarit e brezit 2025 përmendin kryesisht pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet e tyre (44%, nga 35% në 2024) dhe pagën apo kushtet më të mira që u ofron puna aktuale (40%, nga 45%). Ndërkohë, 6,7% shprehen se nuk dëshirojnë të punojnë në një punë që lidhet me studimet e tyre, ndërsa 2,2% raportojnë mungesë të ofertave të punës në fushën e tyre në rajon, krahasuar përkatësisht me 8% dhe 3% në 2024.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024- 2025)

	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	35%	**44%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	8%	**6.7%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	3%	**2.2%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	45%	**40%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=40), **2025** (N=45)

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 41% e të gjurmuarve, këtu vihet re një rënie me 15 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë, 19% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë studimeve nga 14% që ishte një vit më parë. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin "disi" për vitin 2025 është 25%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	14%	14%	17%	18%	38%
2025	**19%**	**16%**	**25%**	**17%**	**24%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=120), **Baza: 2025** (N=157)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 38% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë" me një rënie me 13 pikë përqindje në krahasim me 51% të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, 33% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit me një rritje me 3 pikë përqindje krahasuar me përqindjen e vitit të kaluar.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	20%	10%	19%	19%	32%
2025	15%	18%	29%	21%	17%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=120), **2025** (N=157)

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 11), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 22% deri në 50,000 lekë, 12% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 18% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 10% paguhen në fashën 80,001 – 95,000 lekë, 10% paguhen 95,001- 120,000 lekë dhe 28% paguhen mbi 120,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=125

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 12) tregon se niveli i pagave për të diplomuarit e vitit 2025 ka vijuar trendin pozitiv të përmirësimit. Vihet re një rënie në kategorinë më pak se 35,001 ku nga 7% që ishte vitin e kaluar në 2025 kemi 0%. Gjithashtu kemi rënie në kategorinë 35,001- 50,000 lekë nga 31% në 2024 në 23% në 2025 si dhe në kategorinë 50,001 – 65,000 lekë nga 16% në 2024 në 11% në 2025.

Rritje e lehtë vërehet në kategorinë 65,001 – 80,000 lekë, ku 16% e të diplomuarve në 2025 paguhen në këtë interval, krahasuar me mesataren 13% të një viti më parë.

Rritja më e theksuar shfaqet përsëri te kategoria e pagave më të larta. 50% e të diplomuarve të vitit 2025 marrin më shumë se 80,000 lekë, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 16 pikë përqindje nga një vit më parë (34%).

Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2025**: N=125


Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 13), vëmë re se vetëm 67% e të diplomuarve në Ndërtim, 47% e të diplomuarve në TIK dhe 29% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 20% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes, 20% e të diplomuarve në Mekanikë, 14 e të diplomuarve në SHMT dhe 11% e të diplomuarve në Termohidraulikë marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Ndërkohë, 20% e të diplomuarve në Mekanikë, 18% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes, 17% e të diplomuarve një Termohidraulikë dhe 18% e të diplomuarve në SHMT marrin një pagë 50,001 – 60,000 lekë. 18% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 33% e të diplomuarve në Ndërtim, 31% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 25% e të diplomuarve në SHMT marrin një pagë 60,001 – 80,000 lekë.

Pagë 80,001-95,000 Lekë marrin 20% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes , 14% e të diplomuarve në SHMT, 11 % e të diplomuarve në Hoteleri – Turizëm dhe 13% e të diplomuarve në Mekanikë.

Në kategorinë e pagës 95,001 -120,000 lekë marrin 14% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm, 14% e të diplomuarve në SHMT, 13% e të diplomuarve në TIK, 11% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 7% e të diplomuarve në Mekanikë.

Për më tepër, 43% e të diplomuarve në Hoteleri – Turizëm, 40% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes, 39% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 38% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 20% e të diplomuarve në Mekanikë, 14% e të diplomuarve në SHMT dhe 13 e të diplomuarve në TIK marrin një pagë mbi 120,000 Lekë.

Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%.

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 14), të dhënat tregojnë se 44% e të diplomuarave të gjinisë femërore marrin një pagë deri në 50,000 lekë, .11% e tyre marrin një pagë 50,001- 60,000 lekë, 11% e tyre marrin një pagë 60,001 – 80,000 lekë, 11% një pagë 80,001- 95,000 lekë, dhe 22% marrin një pagë mbi 120,000 lekë.

Ndërkohë, 21% të diplomuar të gjinisë mashkullore marrin një pagë deri në 50,000 lekë, 12% të tjerë marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Për më tepër, 18% e djemve marrin një pagë 60,001 – 80,000 lekë, 9% marrin 80,001- 95,000 lekë, 11% marrin një pagë 95,001-120,000 lekë dhe 28% marrin një pagë mbi 120,000 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_M=83; N_F=12

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), 90% e të diplomuarve (2025) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 4% e të diplomuarve punojnë me kohë të pjesshme dhe po 6% me kohë të plotë sezonale. Krahasuar me një vit më parë vihet re një rritje me 7 pikë përqindje e të diplomuarve që punojnë me kohë të plotë.


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125),

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 16), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2025) vërehet se 40% e të diplomuarve punojnë në kompani 1-4 punonjës me një rritje prej 4 pikë përqindje nga mesatarja viti i mëparshëm; 34% punojnë në kompani me 5-9 punonjës duke ruajtur të njëjtën pikë përqindje me vitin e mëparshëm; 14% e të diplomuarve punojnë në kompani me 10-49 me 7 pikë përqindje më pak se një vit më parë; dhe 12% punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës me një rritje prej 3 pikë përqindje nga një vit më parë


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125)

Në vitin 2025, 60% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 15). Nga ku, 30% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 30% me afat të caktuar. Ndërkohë, 36% nuk kanë një kontratë dhe vetëm 4% po bëjnë praktikën.

Figura 18: Lloji i kontratës (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125)

Sipas rezultateve të gjurmimit të brezit të diplomuarve të vitit 2025, 85% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 18). Ndërkohë, 23% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 9% shprehen se

nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet. Në krahasim me një vit më parë vihet re një rritje e ndërgjegjësimit rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 71% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5) me një rritje prej 7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, 21% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen "shumë të pasigurt ose të pasigurt". Me një rritje prej 3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe 9% u shprehen "shumë të pakënaqur" ku dhe vihet re një rënie me 3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024-2025)

	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	13%	**13%**
I/e pasigurt	5%	**8%**
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	18%	**8%**
I/e sigurt	37%	**33%**
Shumë i/e sigurt	27%	**38%**


Shumë i/e pakënaqur	12%	**9%**
I/e pakënaqur	6%	**7%**
As i kënaqur as i pakënaqur/ neutral	10%	**11%**
I/e kënaqur	37%	**39%**
Shumë i/e kënaqur	35%	**34%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125)

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 66% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur ta gjejnë punën para diplomimit, 14% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 7% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 5% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit dhe 3% kanë gjetur punë 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, 6% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=125

Në një vështrim krahasues me brezin e mëparshëm e të diplomuarve (shiko tabelën 6), vihet re në rënie me 2 pikë përqindje e të diplomuarve që gjejnë punë para diplomimit duke shkuar në 66% për vitin 2025 nga 68% në vitin paraardhës. Nga ana tjetër për vitin 2025, kemi një rritje me 4 pikë përqindje nga një vit më parë (10%) të të diplomuarve të cilët e gjejnë punën 1 muaj pas diplomimit duke shkuar në 14% në 2025. Ndërkohë, është rritur me 2 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit (5% në 2024 dhe 7% në 2025). Gjithashtu është rritur me 1 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët gjejnë punë 3-6 muaj pas diplomimit (5% në 2025, 4%

në 2024). Nga ana tjetër vihet re një rënie me 1 pikë përqindje nga 2024 (6%) e të diplomuarve të cilët gjejnë punë 9-12 muaj pas diplomimit duke shkuar në 5% në 2025.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2024-2025)

	2024	2025
Para diplomimit	68%	66%
1 muaj pas diplomimit	10%	14%
1 - 3 muaj pas diplomimit	5%	7%
3 - 6 muaj pas diplomimit	4%	5%
6 - 9 muaj pas diplomimit	6%	3%
9 - 12 muaj pas diplomimit	6%	5%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2025** (N=72).

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për brezin e fundit të gjurmuarve lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. 62% e të diplomuarve të vitit 2025, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale me një rënie me 2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Për më tepër,22% e të diplomuarve kanë gjetur punë nga praktika profesionale në biznes me një rritje prej 5 pikë përqindje krahasuar me 2024 dhe 9% kanë gjetur punë nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta ku vihet re një rënie me 3 pikë përqindje krahasuar me 2024.

Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024- 2025)

	2024	2025
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	11%	9%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	64%	62%
Nga praktika profesionale në biznes	17%	22%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	3%	4%
Nga mësuesit	2%	0%
Nga Zyra e punësimit	1%	1%
Tjetër	2%	3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=95), **2025** (N=125)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 7), në vitin 2025, 28% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë me një rritje prej 2 pikë përqindja krahasuar me një vit më parë; 31% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim me një rënie të konsiderueshme prej 7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, dhe 15% pohuan që shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë me një rritje prej 4 pikë përqindje krahasuar me 2024. Në vitin

2025, 24% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar duke ruajtur të njëjtën përqindje si një vit më parë.

Tabela 8 Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024-2025)


	2023	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	26%	**28%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	38%	**31%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	11%	**15%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	24%	**24%**
Tjetër	10%	**12%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (**N=120), **2025 (**N=157)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, vetëm 14% (N=33) e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 11% (N=17) e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2025 shprehen se janë student/kursant.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (**N=181), **2025 (**N=230).

Në vitin 2024 të gjithë të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin pra 100% me një rritje prej 10 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (**N=29), **2025 (**N=33).

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 76% studiojnë në institucione publike me një rënie me 17 pikë përqindje nga 2024 dhe 24% në ato private me një rritje me 17 pikë përqindje krahasuar me 2024.

Figura 23: Lloji i institucionit (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (**N=29), **2025 (**N=33).

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 22), 64% e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani

lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 36% të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Krahasuar me një vit më parë vihet re një rënie me 29 pikë përqindje e të gjurmuarve janë shprehur se studimet që po ndjekin nuk lidhen me shkollën që kanë bërë.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=29); **2025** (N=33);

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 8), 42% e të diplomuarve në 2025 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë, 27% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë, 24% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale dhe 6% pasi nuk po gjenin dot punë.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024- 2025)

	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	52%	**42%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	28%	**27%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	14%	**24%**
Nuk po gjeja dot punë	7%	**6%**


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=29), **2025** (N=33).

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 17% (N=40).

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 75% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po kërkonin punë. Krahasuar me një vit më parë vihet re një rritje me 9 pikë përqindje. Ndërkohë 25% e të diplomuarit e papunë nuk janë në kërkim të një pune.

Figura 25: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=38);) **2025** (N=40)

Të dhënat në tabelën 10 sugjerojnë se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mungesa e eksperiencës së punës (30%), mungesa e ofertave për punë që lidhen me arsimimin (30%), mungesa e njohjeve/ kontakteve të duhura për të gjetur një punë (20%) etj.

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2024 2025)


	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	24%	**30%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	20%	**30%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	28%	**20%**
Nuk ka punë në qarkun tim	12%	**0%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	4%	**10%**
Tjetër	4%	**10%**

Nuk di si të kërkoj për punë	8%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=25), **2025** (N=10).

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 26), 61,6% e të diplomuarve të papunë që kërkojnë punë mbështeten te njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë. Praktika profesionale në biznes përbën formën e dytë më të përdorur (21,6%), e ndjekur nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta (8,8%). Ndërkohë, 4,0% kontaktojnë drejtpërdrejt punëdhënësit, vetëm 0,8% kërkojnë punë nëpërmjet Zyrës së Punësimit dhe 3,2% përdorin forma të tjera.

Figura 26: Metodat e kërkimit për punë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=125).

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 10), 39% të diplomuarit e papunë në vitin 2025 u shprehën se po prisnin të fillonin punë së shpejti, gjithashtu po 30% se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin, 20% u shprehën se kishin plan të largoheshin nga vendi dhe 10% u shprehën se janë me aftësi ndryshe.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024 - 2025)

	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	39%	**30%**
Nuk kam besim se do gjej një punë	8%	**0%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	15%	**30%**
Kam në plan të largohem nga vendi	23%	**20%**
Jam me aftësi ndryshe	0%	**10%**
Tjetër	29%	**10%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=13), **2025** (N=10)

Për vitin 2025, 55% e të diplomuarve të papunë kanë pohuar se kanë qenë në një marrëdhënie pune më parë, ku vihet re një rritje me 18 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë . Ndërsa, 45% e të diplomuarve të papunë kanë qenë në marrëdhënie pune më herët.

Figura 27: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=38), **2025** (N=40).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit, është tek nevoja për përmirësimin e praktikave në shkollë (55%), përmirësimi i bashkëpunimit me bizneset (57%), përmirësimin e praktikave në biznes (56%), këshillimi në karrierë (53%) etj.


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024- 2025)

	2024	2025
Infrastruktura	63%	**43%**
Kurrikula	56%	**45%**
Tekstet dhe materialet	67%	**48%**
Metodat e mësimdhënies	66%	**50%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	65%	**50%**
Praktika në shkollë	71%	**55%**
Praktika në biznes	68%	**56%**
Këshillimi i karrierës	66%	**53%**
Bashkëpunimi me bizneset	70%	**57%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	62%	**53%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N= 166* ndryshon nga kategoria); **2025** (N= 230* ndryshon nga kategoria);

Nëse do të kishin mundësi, 81% e të diplomuarve në vitin 2025 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 72% të njëjtën shkollë (shiko figurën 26).

Figura 28: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=181); **2025** (N=230);

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 12. Për vitin 2025, nivelin më të lartë të të diplomuarve që do të zgjidhnin të njëjtën shkollë janë të diplomuarit e Ekonomi- Biznes me 92% ndjekur nga 87% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 85% e të diplomuarve në TIK, 78% e të diplomuarve në Elektroteknikë etj.

Ndërkohë, 100% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes, 93% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 85% e të diplomuarve në TIK, 78% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 73% e të diplomuarve në Ndërtim do të përzgjidhnin të njëjtën degë.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025)

		Ekonomi-Biznes	Elektroteknikë	Hoteleri - Turizëm	Mekanikë	SHMT	Ndërtim	TIK	Termohidraulikë
2024	Degë	75%	86%	85%	59%	73%	-	63%	-
	Shkollë	92%	76%	85%	94%	75%	-	74%	-
2025	**Degë**	**100%**	**87%**	**81%**	**77%**	**70%**	**73%**	**85%**	**93%**
	Shkollë	**92%**	**78%**	**58%**	**64%**	**65%**	**73%**	**85%**	**87%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2024:**N_{EB}=12 N_{ELE}=29; N_{HT}=26; N_{MEK}=17; N_{TK}=6; N_{SHMT}=44, N_{TIK}=19, N_{ISH}=28, **Baza 2025:**N_{EB}=13 N_{ELE}=23; N_{HT}=18; N_{MEK}=22; $N_{Ndë}$=11; N_{SHMT}=54, N_{TIK}=33, N_{ter}=30

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi dhe shkollë jepet në figurën 27. Kështu, 73% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 67% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, 81% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe po 88% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=206); F (N=24)

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 45% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre.

Për më tepër, 28% duan të kenë gjetur një punë që lidhet me profesionin e tyre, si dhe 27% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë të punësuar. Ndërkohë, për vitin 2025, 9% e të diplomuarve planifikojnë të emigrojnë jashtë vendit në dy vitet e ardhshme, 10% e të diplomuarve kanë dëshirë për të ndjekur studimet e mëtejshme. Ndërsa vetëm 3% e të diplomuarve kanë shprehur dëshirën për të migruar në një qytet tjetër brenda vendin.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024- 2025)

	2024	2025
Të jem punësuar	22%	**27%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	21%	**28%**
Të kem filluar biznesin tim	46%	**45%**

Të kem ndjekur studime të mëtejshme	7%	**10%**
Të kem emigruar jashtë vendit	11%	**9%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	**3%**
Tjetër	6%	**3%**

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=230)

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për Shkollën Profesionale Elbasan. Për brezin 2025 janë gjurmuar 230 nga 271 të diplomuar, ose 85%. Për nëngrupet me pak përgjigje, nevojiten kontakte individuale për të kuptuar situatën. Mospërputhjet në disa tregues dhe baza përgjigjesh duhen verifikuar para përdorimit të tyre në planifikim.

1. Praktikë më cilësore dhe bashkëpunim më i ngushtë me bizneset

Planet e praktikës në shkollë dhe biznes të rishikohen me mësuesit dhe mentorët, duke përcaktuar detyra konkrete dhe aftësitë që nxënësit duhet të zhvillojnë. Të ndiqet cilësia e praktikës dhe të forcohen partneritetet që krijojnë mundësi punësimi pas diplomimit.

Gjetja: Përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset e kërkojnë 57% e të diplomuarve, të praktikës në biznes 56% dhe të praktikës në shkollë 55% (baza e raportuar: N=230, ndryshon sipas aspektit). Ndërkohë, 22% e kanë gjetur punën e parë përmes praktikës në biznes (N=125).

2. Përmbajtje dhe mësimdhënie më të lidhura me punën

Ekipet lëndore të diskutojnë me të diplomuarit dhe punëdhënësit se cilat njohuri përdoren në punë dhe cilat aftësi kërkojnë më shumë përgatitje. Gjetjet të përdoren për të përmirësuar materialet mësimore, detyrat praktike dhe metodat e mësimdhënies sipas drejtimit.

Gjetja: Vetëm 41% raportojnë se i përdorin njohuritë e fituara në shkollë “shumë” ose “jashtëzakonisht shumë” në punë, ndërsa 19% nuk i përdorin aspak (N=157). Përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe të aftësive teorike e praktike të mësuesve e kërkojnë nga 50%, ndërsa të teksteve dhe materialeve 48% (baza e raportuar: N=230, ndryshon sipas aspektit).

3. Orientim më praktik për punësim dhe mbështetje individuale

Shkolla të ofrojë ushtrime për përgatitjen e CV-së, aplikimin dhe intervistën, si dhe të lehtësojë kontaktet me punëdhënësit dhe Zyrën e Punësimit. Të diplomuarit pa punë të kontaktohen individualisht për të kuptuar pengesat dhe për të përshtatur mbështetjen.

Gjetja: Vetëm 28% raportojnë se shkolla i ka mësuar të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, ndërsa 15% se i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës; 24% shprehen se përgjithësisht nuk i ka ndihmuar (N=157). Nga 40 të diplomuarit pa punë, 75% kërkojnë punë. Përmirësimin e këshillimit në karrierë dhe të bashkëpunimit me zyrat e punësimit e kërkojnë nga 53% e të diplomuarve.

4. Më shumë vëmendje ndaj kontratave dhe sigurimeve

Orientimi në karrierë të përfshijë informacion praktik mbi kontratat, kushtet e punës dhe mënyrat e verifikimit të kontributeve. Në kontaktet pas diplomimit të identifikohen të diplomuarit që kanë nevojë për sqarim ose orientim drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Në vitin 2025, 36% e të punësuarve raportojnë se nuk kanë kontratë pune (N=125). Të dhënat për sigurimet kërkojnë verifikim, pasi përqindjet e paraqitura në narrativë për pagesën, mospagesën dhe mungesën e informacionit arrijnë së bashku në 117%.

5. Mbështetje praktike për planet e sipërmarrjes

Të diplomuarve që synojnë hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe planifikimin financiar. Shkolla të krijojë kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse, duke dalluar interesin e përgjithshëm nga planet konkrete për fillimin e një aktiviteti.

Gjetja: Për dy vitet e ardhshme, 45% e të diplomuarve dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre. Kjo është alternativa më e përzgjedhur në planet për të ardhmen, përpara gjetjes së një pune që lidhet me fushën e studimit (28%) dhe punësimit në përgjithësi (27%). Baza e raportuar është N=230, por viti në shënimin e tabelës duhet korrigjuar.